

HYRJE

Ky është Buletini i 16-të i Këshillit të Ankesave në përmbajtje të të cilit janë ankesat e trajtuara përgjatë periudhës Janar-Qershor 2024. Nga shqyrtimi i tyre rezulton se përmbajtjet mediatike vijojnë të jenë problematike sa i takon respektimit të drejtave të njeriut, kryesisht në cenimin e imazhit, jetës private, drejtave të fëmijëve por edhe etikës në komunikim.

Zhvillimet teknologjike kanë sjellë edhe ndryshime thelbësore mbi sjelljen e audiencave apo konsumatorëve të informacionit dhe përmbajtjes mediatike.

Në një kohë kur shumica e përmbajtjeve mediatike nuk mjaftohen vetëm me pasqyrimin e realitetit. Ato e rikrijojnë atë, zakonisht me një vlerë të veçantë ose perspektivë tjetër. Pasqyrimet e mediave nuk janë asnjëherë, ato përcjellin mesazhe konkrete, komunikojnë vlera, besime dhe ide.

Kjo situatë e re i ka zgjuar aktorët tradicionalë të medias, të cilët deri dje kishin pozicionin e monopolit në informacion. Nëse deri dje gazetarë, politikanë apo grupe të ndryshme të interesit ishin “aktorët” kryesore të komunikimit tradicional publik, rëndësia në rritje e komunikimit në rrjetet sociale ka sjellë si rezultat dhe një ndryshim themelor në komunikimin publik. Ky lloj konfigurimi në procesin e komunikimit publik apo komunikimit politik tashmë ka ndryshuar, ndërkohë që publiku ka marrë një rol të rëndësishëm kryesisht prej pjesëmarrjes apo e-pjesëmarrjes.

Me digjitalizimin, shpejtësia e publikimit të një materiali është bërë punë sekondash. Përballimi i konkurrencës është një ndjenjë përparësi në gazetari dhe rezultati ndonjëherë mund të jetë një publikim që nuk është verifikuar me kujdes në lidhje me paanshëmrinë në zgjedhjen e fjalëve, burimet e ekuilibruara apo kontekstin e mjaftueshëm. Informacioni kontekstual është kritik për të kuptuar plotësisht një ngjarje të kohës si dhe për kuptimin e rëndësisë së një ngjarjeje nga ana e konsumatorëve, por fokusi i mediave në lajmet e fundit është shpesh në kurriz të kontekstit.

Ndryshimet teknologjike kanë ndikuar në cilësinë e jetës shoqërore, me pasqyrim të drejtpërdrejtë edhe peizazhin mediatik duke nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve në diskutimin publik.

Gjatë kohëve të fundit, duket sikur i gjithë diskursi shoqëror dhe politik zhvillohet në rrjetet sociale, “Facebook”, “Twitter”, “Instagram”, si dhe në platformat e shpërndarjes së videove, sikurse “YouTube” apo “Tik Tok”.

Këshilli i Ankesave si strukturë në mbështetje të ligjit nr.97/2013 “*Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar dhe aktit nënligjor Kodit të Transmetimit ka shërbyer si “urë” lidhëse mes qytetarëve dhe OSHMA-ve për trajtimin sa më efikas të këtyre ankesave.

Në këtë kuadër Këshilli i Ankesave ka zhvilluar edhe disa takime, me fokus Edukimin Mediatik. Edukimi Mediatik si një mënyrë e të menduarit kritik për përmbajtjen, moderimi në përdorimin e medias dhe marrëdhëniet ndërpersonale me njerëz të ndryshëm-këto janë “antidote” ndaj pasqyrimeve të dëmshme mediatike.

ANKESA ME OBJEKT “CENIMIN E RREGULLAVE TË ETIKËS DHE DINJITETIT”

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë	TV News 24	“Fit Station”	23.01.2024

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë referuar rubrikës “Fit station”, transmetuar në televizionin News 24 në datën 6 Janar 2024 në orën 20:59, përmes së cilës shprehej shqetësimi *“në lidhje me denigrimin e besimit orthodhoks nga ana e një individi nga Elbasani, i quajtur Nikolla Xhufka, një laik që vetëshpallet pa asnjë të drejtë fetare dhe ligjore prift orthodhoks”*.

Sipas ankuesit *“...individi N.Xhufka ishte ftuar në TV News 24 duke e paraqitur si prift orthodhoks, përveç denigrimit të figurës së nderuar të klerikut orthodhoks, ai kaloi në sharje, fyerje e të pavërteta ndaj Kryepiskopit Anastas dhe Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, pa asnjë lloj kundërtënie nga drejtuesja e emisionit...”*.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadrin e administrimit të ankesës dhe shqyrtimit të saj, referuar nenit 51 të ligjit nr. 97/2013 *“Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes”*, si dhe udhëzimit *“Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv”*, Këshilli i Ankesave i kërkoi Bordit të Shqyrtimit të Ankesave pranë televizionit News 24 paraqitjen e pretendimeve lidhur me ankesën e sipërcituar.

Subjekti audioviziv “News 24” nuk pati asnjë reagim në lidhje me kërkesën e Këshillit të Ankesave për paraqitje pretendimesh brenda afatit prej 7 ditësh.

Megjithatë, në vijim të trajtimit të ankesës dhe bazuar në Ligjin nr.97/2013 *“Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, neni 52, pika 6, që parashikon se *“....gjatë procedurave të zgjidhjes së ankesës, Këshilli i Ankesave mund të vendosë organizimin e seancave dëgjimore me palët”*, Këshilli i Ankesave, në datën 11.03.2024 i dërgoi ftesë për seancë dëgjimore palëve përkatëse, Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë dhe Subjektit Audioviziv “News 24”.

Seanca dëgjimore u organizua në 20 Mars 2024, ora 13:00, në zyrat e Autoritetit të Medias Audiovizive me pjesëmarrjen e palëve, si dhe AMA. Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, z. Doli në hap fakti që OSHMA-ja për shkaqe administrative ankesa e Kishës Autoqefale Orthodhokse ishte arkivuar. Me marrjen e shkresës nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, media kishte filluar

komunikimin me përfaqësues të kishës. Në lidhje me objektin e ankesës, përfaqësuesi i OSHMA-së duke patur parasysh formatin televiziv në të cilin ishte i ftuar personazhi, ishin neglizhuar pyetjet mbi statusin ligjor, pasi për moderatoren nga veshja e tij ishte e identifikueshme. Për sa më sipër u ra dakord që personazhi të mos thirrej më në cilësinë e përfaqësuesit të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë. Po kështu, u ra dakord të hiqen materialet audiovizive të deritanishme, me këto personazh, në çdo platformë të OSHMA-së.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pasi dëgjoi me vëmendje parashtrimet e palëve pjesëmarrëse në seancë dëgjimore dhe pas dakordësisë së vendosur në lidhje me respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni shqiptar, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive e konsideroi të mbyllur administrimin e ankesës.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
AWA	Top Channel TV Klan	Programacioni	12.02.2024

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga shoqata Albanian Woman in Audiovisual (AWA) përmes së cilës shprehej shqetësimi në lidhje me *“pamjet e shpërndara nga Top Channel dhe TV Klan, ndjekur dhe nga televizione të tjera, në lidhje me rastin e 34 vjeçarit, shfaqet duke dhunuar bashkëshorten e tij në prani të fëmijëve”*. Sipas ankuesit, *“ky portretizim , jo vetëm që promovonte dhunën, por gjithashtu devijonte në mënyrë të konsiderueshme nga parimet e gazetarisë së përgjegjshme”*.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadrin e administrimit të ankesës dhe shqyrtimit të saj, Këshilli i Ankesave nisi verifikimet lidhur me pasqyrimin e përgjithshëm mediatik të ngjarjes jo vetëm nga OSHMA-të e referuara por nga të gjitha subjektet audiovizive nën monitorim.

Në këtë kuadër, Këshilli i Ankesave këqyri me vëmendje përmbajtjet audiovizive, nga edicionet informative e deri tek emisionet e transmetuara prej OSHMA-ve në datat e referuara, nga ku evidentoi shmangie prej:

Ligjit nr.97/2013 *“Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, në:

nenin 4, pika 1/b; neni 46, pika 2/ç).

dhe

Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60, datë 10.07.2023, në:
seksionin 1, pika 1.4, seksionin 3, pika 3.18, seksionin 4, pika 4.24.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nisur nga sa më sipër, Këshilli i Ankesave, bazuar në “Rregulloren për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtën e përgjigjes”, e ndryshuar me vendimin e AMA-s, nr.56, datë 07.07.2023, neni 6 “Konkluzionet e Këshillit të Ankesave”, pika 4, i tërhoqi vëmendjen operatorëve audiovizivë të mëposhtëm:

Top Channel, Vizion Plus, TV Klan, Klan Plus, News 24, Abc News, Syri TV, MCN TV, Euronews Albania

për shmangie nga ligji nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Kodi i Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60, datë 10.07.2023 dhe u kërkoi heqjen e videos përkatëse prej llogarisë së tyre në YouTube brenda një afati prej 30 ditësh.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
“Kolektivi Feminist”	EuroNews Albania TV Klan	“Now me Erla Mëhillin”	15.02.2024

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga shoqata Kolektivi Feminist përkitazi emisionit “NOW me Erla Mëhillin”, transmetuar në televizionin Euronews Albania më datë 13 Shkurt 2024. Ankueset ngrinin shqetësimin se “*ndaj znj. Lekatari u përdorën shprehje seksiste, ofenduese dhe denigruese si “zemra ime”, “ti nuk je inteligjente”, “ti do vëmendje”, “ti nuk je klerike”, “ti merr lekë” etj.....*” dhe gazetarja u cilësua “*si individ, që nuk ka tagër për të folur për tematika gjinore, se nuk është nënë...*”. Ankuesi kërkonte nga Këshilli i Ankesave marrjen e masave për heqjen e videos nga YouTube dhe rrjetet sociale të EuroNews Albania.

2.Administrimi i ankesës

Në kuadrin e administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), referuar nenit 51 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes” si dhe udhëzimit “Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv”, iu drejtua Bordit të Shqyrtimit të Ankesave pranë Euronews Albania për të kërkuar paraqitje pretendimesh lidhur me këtë ankesë.

Në përgjigjen e vet, subjekti audioviziv Euronews Albania, argumentoi se:

- “Pavarësisht përpjekjeve maksimale për të ruajtur qetësinë, situata ishte përshkallëzuar.
- Pas shqetësimit të shfaqur të znj. Lekatari, u morën masa të menjëhershme për zgjidhjen e situatës. Prezantuesja e emisionit znj. Erla Mëhilli ka kontaktuar zonjën Lekatari gjatë dhe pas emisionit lidhur me incidentin në fjalë dhe është treguar bashkëpunuese dhe e gatshme për gjetjen e një zgjidhjeje për situatën.
- Z. Bregu u largua menjëherë nga paneli dhe u morën masa për të redaktuar çdo përmbajtje fyese nga transmetimi. ... Incidenti në asnjë moment nuk mund të ishte parashikuar nga dikush i kalibrit të tij...
- U morën masa të menjëhershme për fshirjen e pjesëve nga YouTube dhe platformat e tjera... Përkushtimi ynë për të denoncuar të gjitha format e dhunës, përfshirë dhunën me bazë gjinore, mbetet i palëkundur.”

2. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Për sa më sipër, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, e konsideroi reagimin e OSHMA-së në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, Nr. 60, dt. 10.07.2023.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
G.Ç	Abc News	“Zonë e lirë”	16.02.2024

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga shtetasi G.Ç në lidhje me emisionin “Zonë e Lirë” transmetuar në datën 16 Shkurt 2024 në orën 21:00, ku ai shprehte pretendimin se “emisioni Zonë e Lirë mbyllet me këngën Moje More, të një këngëtare serbe....” dhe pyeste: “A e ka njeri idenë se çdo të thotë kjo këngë, dhe a ka njeri idenë se kush janë zogjtë e zinj dhe si anatemohen shqiptarët ?????”.

2. Administrimi i ankesës

Në kuadrin e administrimit të ankesës, referuar nenit 51 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes”, si dhe udhëzimit “Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv”, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive iu drejtua televizionit “Abc News” me kërkesën për paraqitje pretendimesh lidhur me ankesën në fjalë.

Në përgjigje të kërkesës për paraqitje pretendimesh të Këshillit të Ankesave “Abc News” argumentoi për Këshillin e Ankesave si vijon:

“Bashkangjitur me këtë shkresë po ju dërgojmë edhe tekstin e këngës, të përkthyer, ku nuk përmend as shqiptarët dhe as Shqipëria”.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Sa më sipër, Këshilli i Ankesave konstatoi, se përmbajtja për të cilën ju ankohej shtetasi G.Ç nuk binte ndesh me kërkesat e Ligjit Nr. 97/ 2013 *“Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 60 datë 10.07.2023.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Kisha Orthodoxe	Abc News	“360 gradë”	26.02.2024
Autoqefale e Shqipërisë			

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori disa ankesa nga Kisha Orthodoxe Autoqefale e Shqipërisë referuar emisionit “360 gradë”, transmetuar në televizionin “Abc News”, përmes së cilave shprehej shqetësimi *“në lidhje me denigrimin e besimit orthodhoks nga ana e një individi nga Elbasani, i quajtur Nikolla Xhufka, një laik që vetëshpallet pa asnjë të drejtë fetare dhe ligjore prift orthodhoks”*. Sipas ankuesve, *“përveç denigrimit të figurës së nderuar të klerikut orthodhoks, ai ka kaluar në fyerje dhe gënjeshtër flagrante kundër Kryepiskopit Anastas dhe Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë....të cilat u lejuan nga drejtuesi i emisionit”*.

2. Administrimi i ankesës

Në vijim të trajtimit të ankesës së mësipërme dhe bazuar në Ligjin nr.97/2013 *“Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, neni 52, pika 6, ku parashikohet se *“....gjatë procedurave të zgjidhjes së ankesës, Këshilli i Ankesave mund të vendosë organizimin e seancave dëgjimore me palët”*, Këshilli i Ankesave organizoi një seancë dëgjimore me palët, në zyrat e Autoritetit të Medias Audiovizive.

Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, përfaqësuesja e subjektit audioviziv “Abc News” tha se e kishte gjetur të drejtë shqetësimin e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë dhe se ky qëndrim ishte reflektuar edhe në komunikimin që përfaqësuesit e Kishës kishin patur me drejtuesin e televizionit “Abc News”.

Nga ana tjetër, përfaqësuesja e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë konfirmoi dakordësinë e arritur mes përfaqësuesve të Kishës, konkretisht midis z.Thoma Dhima dhe drejtuesit të televizionit Abc News, z.Sokol Balla. Ky i fundit, pasi ishte njohur me pretendimin e **paraqitur nga** përfaqësuesit e Kishës, kishte pranuar se ai ishte një akt i rëndë dhe nuk do përsëritej më nga OSHMA-ja që ai drejtonte.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pasi dëgjoi palët pjesëmarrëse në seancë, Këshilli i Ankesave theksoi rëndësinë e lirisë së medias dhe mendimit kritik por gjithmonë duke qartësuar pozicionet dhe përfaqësimin e kujtudo që përcjell informacione për publikun.

Në përfundim të diskutimeve të palëve pjesëmarrëse në seancë dëgjimore dhe dakordësisë së vendosur në lidhje me respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni shqiptar, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive e konsideroi të mbyllur administrimin e ankesës.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
N. Dh	TV Klan	E diela Shqiptare	10.03.2024

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga shtetasja N. Dh përmes së cilës kërkonte të informohej “*nëse emisioni e Diela Shqiptare, rreth orës 18.30-19.00 kishte kryer një shkelje duke ekspozuar një grua me të brendshme që i behej masazh publikisht*”. Ankuesja pretendonte se “*një shfaqje e tillë është denigruese për gruan...*”.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës në fjalë, Këshilli i Ankesave këqyri me vëmendje përmbajtjen audiovizive të emisionit “E diela Shqiptare”, transmetuar në televizionin “Klan” në datën e referuar dhe evidentoi se:

- në emision demonstrohet aplikimi i një masazhi terapeutik me kupa,
- aplikimi i masazhit kryhet nga një estetist profesionist ndërsa protagonistja, me dëshirën e saj, ishte një prej zonjave të publikut.

Nisur nga sa më sipër, Këshilli i Ankesave vlerësoi se demonstrimi në fjalë kishte për qëllim vetëm promovimin e masazhit si mjet që mbështet dhe përmirëson shëndetin.

Në përmbajtjen audiovizive të referuar nuk evidentoheshin elemente të denigrimit, në kuptimin e “errësimit, zvogëlimit ose uljes me qëllim të vlerave të dikujt” (Fjalori i Gjuhës Shqipe – ASHSH 2006). Produksioni ishte kujdesur, që kamera të mos e fokusonte zonjën, në momentin e heqjes së bluzës dhe rikthehej tek ajo vetëm pasi ajo kishte zënë vend në shtratin e masazhit. Edhe reagimet e vetë zonjës nuk linin shkas dyshimi për ndjesi jo pozitive, përkundrazi promovonin gjatë gjithë kohës mirëqenien e saj.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Për sa më sipër, Këshilli i Ankesave nuk konstatoi shkelje të Ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 60 datë 10.07.2023.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
F.K	TV Klan	E diela Shqiptare	18.03.2024

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga shtetasi F.K. me pretendimin se në rubrikën “Shihemi në Gjyq”, pjesë e emisionit “E Diela Shqiptare” transmetuar në Televizionin Klan, *“e ftuara i kishte përdorur emrin duke e akuzuar si falsifikator në mënyrë të padrejtë ...dhe ... mashtrues”*. Sipas ankuesit, *“Këto akuza u hodhën në sy të drejtuesit të emisionit Ardit Gjebrea, i cili për asnjë moment nuk reagoi...”*.

1. Administrimi i Ankesës

Pas këqyrjes me vëmendje të përmbajtjes audiovizive të rubrikës “Shihemi në Gjyq”, pjesë e emisionit “E diela Shqiptare”, transmetuar në televizionin “Klan”, Këshilli i Ankesave evidentoi se në rubrikën “Shihemi në Gjyq”, transmetuar në datën e referuar mbahej seanca e ndërmjetësimit nga Znj.Eni Çobani dhe moderatori i programit, Z.Ardit Gjebrea, ku trajtohej konflikti mes dy bashkëshortëve dhe çështjet e pronësisë mes palëve. Këshilli i Ankesave vlerësoi se, përkundër pretendimit të ankuesit, znj. Eni Çobani në cilësinë e drejtueses në seancën e ndërmjetësimit dhe gjithashtu bashkëmoderatore e rubrikës “Shihemi në Gjyq” u distanca nga akuzat e ankuesit.

2. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Sa më sipër, Këshilli i Ankesave konstatoi se përmbajtja audiovizive e rubrikës “Shihemi në Gjyq” të emisionit “E Diela Shqiptare” transmetuar në datën e referuar nuk binte ndesh me kërkesat e Ligjit Nr. 97/ 2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë” dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 60 datë 10.07.2023

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
D.M	Top Channel	“Fiks Fare”	27.03.2024

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga shtetasi D.M. në lidhje me emisionin “Fiks Fare”, transmetuar në televizionin “Top Channel”, me objekt:

- *“Detyrimin e shoqërisë Top Channel sh.a për të hequr të gjitha shkrimet dhe publikimet, që përmbajnë thëniet e pavërteta, në portalet e lajmeve, në kronikat dhe emisionet e publikuara prej saj, në YouTube, në faqen e saj të internetit....*
- *Detyrimin e Top Channel sh.a për publikimin e përgënjeshtërimit publik si dhe dëmshpërblimit për dëmin jopasuror të shkaktuar si rezultat i fyerjes dhe shpifjes publike,*

me pasojë cenimin e nderit, personalitetit, të jetës private, familjare e shoqërore dhe reputacionin si individ dhe si profesionist Noter, si dhe detyrimin pasuror në vlerën monetare 39 milionë euro, si pasojë e dëmit material e moral dhe psikologjik të rëndë, të shkaktuar nga cenimi i drejtpërdrejtë të dinjitetit dhe reputacionit tim në familje dhe publik”

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës në fjalë, Këshilli i Ankesave këqyri përmbajtjen audiovizive të emisionit “Fiks Fare”, transmetuar në televizionin “Top Channel”, në datën e referuar dhe evidentoi se:

- emisioni fokusohej te rasti i një qytetari në lidhje me një procedurë noteriale të bërë prej ankuesit në vitin 2015.
- qasja, trajtimi dhe interpretimi i fakteve nga ana e formatit dhe gazetares ishin pjesë e kompetencave editoriale të medias dhe lirisë profesionale të gazetarit dhe për pasojë në mbrojtjen e ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas të cilit *“veprimtaria e transmetimeve audiovizive është e lirë”* (neni 4, pika 1/a).
- për trajtimin e ngjarjes, OSHMA-ja kishte transmetuar disa materiale dhe zëra publiku, ndër të tjera ishte paraqitur bashkë me qytetarin në zyrat ku pretendohet se ankuesi ushtronte profesionin e noterit, në respektim të nenit 33, pika 1/b) “Parimet themelore”, i ligjit nr.97/2013 i cili përcakton se *“...çështjet që janë tema të debatit publik, duhet të jetë i drejtë për të gjitha subjektet e interesuara”*.
- pavarësisht dispozitës ligjore, të cilën ankuesi referonte në ankesë (neni 33 i ligjit nr.97/2013), pas këqyrjes së përmbajtjes audiovizive përkatëse dhe kërkesës, citoj: *“prej publikimin e përgënjeshtërimit publik”*, në fakt kërkesa e tij përkonte me nenin 53 “E drejta e përgjigjes”, e ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga shqyrtim i përmbajtjes audiovizive rezultoi se thelbi i çështjes ishte pronësia intelektuale, për të cilën ankuesi deklaronte se *“Çështja është në proces edhe në Gjykatën Administrative dhe Gjykatë të Strasburgut”*, bazuar në nenin 53 “E drejta e përgjigjes”, pika 13/gj) *“çështja objekt ankese lidhet me zhvillimin e seancave gjyqësore..”*, Këshilli i Ankesave refuzoi ankesën në fjalë.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Kisha Orthodhokse Autoqefale	Abc News	360 gradë	02.04.2024

1. Objekti i Ankesës

Përfaqësuesit e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë i dërguan një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), në lidhje me emisionin “360 gradë”, transmetuar në televizionin “Abc News”, në datën 1 Prill 2024, në orën 22:13. Ankuesit shprehnin shqetësimin se “1 prill 2024, po në këtë emision, ishte përsëri i pranishëm qytetari i vetëshpallur si prift, N. Xh ... i cili uzurpon funksionin e klerikut dhe përfaqësimin e institucionit zyrtar shqiptar Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, duke bërë shpifje dhe akuza të pavërteta”.

2. Administrimi i Ankesës

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave këqyri me vëmendje materialin audioviziv përkatës, konkretisht emisionin “360 gradë” të datës 1 prill 2024 në orën 22:13. Nga shqyrtimi i materialit filmik evidentohet fakti se në emision ishte trajtuar tema me titull “Kush kërkon të burgosë At Nikolla Xhufkën?”, me panel diskutues; At Nikolla Xhufka, Enida Bozheku (avokate), Laert Vasili (aktor), Anduena Llabani (gazetare). Të ftuarit diskutonin dhe shprehnin opinionin e tyre në lidhje me akuzat e Kishës Orthodokse Serbe dhe Kishës Orthodokse Autoqefale Shqiptare ndaj At Nikolla Xhufkës. Gjatë diskutimeve dhe prononcimeve të tij At Nikolla Xhufka kishte deklaruar se nuk përfaqësonte Kishën Orthodokse Autoqefale Shqiptare. Gjatë emisionit ishin bërë publike edhe Statuti i Kishës Orthodokse Autoqefale Shqiptare si dhe vërtetimi i Kishës që konfirmonte se At Nikolla Xhufka nuk ishte pjesë e saj.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në vendimmarrjen e tij, Këshilli i Ankesave nënvizoi se garantimi i lirisë së shprehjes dhe të drejtës së informimit (Ligji nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 4, Parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive, pika 2/a dhe b), kur kjo shkon paralelisht me qartësimin e pozicioneve të aktorëve të interesuar dhe kujtudo që përcjell informacione për publikun (Ligji nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 33, Detyrimet e OSHMA-ve, pika 1/a dhe b), Këshilli i Ankesave gjykon se përmbajtja audiovizive e mësipërme nuk ka shmangie nga Ligji nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Kodi i Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60 datë 10.07.2023. Ndaj dhe vendosi që gjykimi i shpifjeve dhe akuzave ndaj Kishës Orthodhokse Autoqefale Shqiptare nga At Nikolla Xhufka si kundërvajtje penale, bie jashtë kompetencave të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
B. Sh	Ballkan Web.com		04-5.04.2024
	SotNews		
	GazetaShqip		
	TV Klan		
	Newsbomb.al		
	Top Albania Radio		

Shqiptarja.com
Droni.al
Gazeta standardonline
Noa.al
Syri.net
Star Plus
TV Shkodër
Google

1. Objekti i Ankesës

B. Sh i drejtoi një ankesë Autoritetit të Mediave Audiovizive me kërkesën për të hequr emrin e tij nga shkrimet në disa media si dhe nga motori i kërkimit “Google”.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes në shqyrtim të ankesës, ankuesit iu bë me dije se Autoriteti i Mediave Audiovizive në cilësinë e tij si autoritet i pavarur rregullator, në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë, vepron në bazë e për zbatimin e dispozitave të ligjit nr.97/2013, të ndryshuar, si dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Bazuar në këto dispozita motori i kërkimeve “Google” nuk ishte nën juridiksionin e Autoritetit. Po kështu, nga verifikimet e adresave rezultoi se përmbajtjet e cituara prej tij, ishin artikuj të publikuar në portale dhe jo përmbajtje audiovizive të transmetuara në mediat audio/audiovizive. Referuar ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (edhe me ligjin nr. 30/2023), neni 2 “Fusha e zbatimit”, mediat online vijojnë të jenë jashtë objektit të veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive i cili është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve audio dhe audiovizive në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Dhjetëra ankues	Top Channel	“Për‘puthen”	05.04.2024

1. Objekti i Ankesës

Dhjetëra ankues i drejtuan një ankesë Këshillit të Ankesave në lidhje me emisionin “Për ‘puthen”, transmetuar në “Top Channel”. Ankuesit pretendonin se në episodin e datës 3 Prill 2024 ishte transmetuar përmbajtje në shkelje të Kodit të Transmetimit me skena +16 përpara orës 21:00. Gjithashtu pretendohet se materiali përmbante fjalor fytes dhe të dhunshëm.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave evidentoi faktin se përmbajtja ishte shqyrtuar nga drejtoria e Monitorimit dhe Analizës në AMA. Këshilli i Ankesave i bëri me dije ankuesve se nga shqyrtimi i përmbajtjes audiovizive rezultoi në shkelje të Ligjit nr.97/2013 dhe Kodit të Transmetimit, duke vendosur sanksion me gjobë subjektit audioviziv “Top Channel” për emisionin “Për ‘puthen” të datës 4 Prill 2024.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
L.H	CNA	Kronikë	22.04.2024

1. Objekti i Ankesës

L.H i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), me pretendimin se “*në datën 5 Prill 2024, në faqen online të CNA.al si dhe në median CNA TV, është publikuar një lajm i sajuar dhe i pabazuar në prova*”. Ankuesja kërkonte përgënjeshttrimin informacionit të publikuar.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave i kërkoi Bordit të Shqyrtimit të Ankesave të OSHMA-së, paraqitjen e pretendimeve në lidhje me ankesën. Në përgjigjen e tyre, Bordi, sqaroi se “*ka pezulluar përkohësisht publikimin e videos në YouTube deri në sqarimin e çështjes*”.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga verifikimet e kryera nga Këshilli i Ankesave, ankueses iu bë me dije se, përmbajtja audiovizive, subjekt i ankesës, transmetuar nga OSHMA-ja dhe publikuar në kanalën e tyre zyrtar në “YouTube” ishte bllokuar. Në lidhje me kërkesën e saj për, “*përgënjeshttrimin e lajmit nga stafi i CNA...*”, sipas ligjit 97/2013 “*Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, do duhej të ishte konsumuar fillimisht me vetë OSHMA-në (neni 53 “E drejta e përgjigjes”, pikat 5,6) dhe t’i drejtohej Këshillit të Ankesave, pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive vetëm pas refuzimit të saj prej OSHMA-së (neni 53, pikat 6,7).

Sa i takon publikimit të përmbajtjes subjekt ankese në faqen “CNA.al”, e cila rezultoi të jetë portal, bie jashtë objektit të veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive, kompetencat e së cilës shtrihen në “*transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare shërbimet mbështetëse të tyre dhe shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove*” (ligji 97/2013, neni 2) dhe për pasojë, jashtë hapësirave ligjore të reagimit të tij.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E. C	TV Mat		07.05.2024

1. Objekti i Ankesës

E.C i kërkoi Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) marrjen e masave ndaj Mat Televizion, me pretendimin se *“mungesa e profesionalizmit të punonjësve të medias, po pengonte në ushtrimin e profesionit.”*

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave evidentoi mungesën e elementëve të domosdoshëm për vijimin e trajtimit të problematikës, ndaj dhe i kërkoi ankueses plotësimin e të dhënave të ankesës në kuadër të administrimit të saj.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.H	Top Channel	Portokalli	24.06.2024

1. Objekti i Ankesës

E.H i kërkoi Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) marrjen e masave ndaj një kënge, transmetuar në spektaklin e humorit “Portokalli”, në televizionin “Top Channel”, me pretendimin se grupi *“Viroza” performoi një këngë e tekst që është denigrues për emigrantët shqiptarë kudo që ndodhen*”.

2. Administrimi i Ankesës

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave këqyri me vëmendje përmbajtjen audiovizive transmetuar në spektaklin e humorit “Portokalli” në televizionin “Top Channel”, në datën 12 Maj 2024, në orën 21:00. Nga shqyrtimi i materialit evidentoi se :

- *“Skeçi përmbante tre personazhe humoristike të cilët nën pseudonimin e grupit me emrin “Viroza” këndonin një këngë me titull “Kur dalim jashtë shtetit”, përmes një teksti i cili në mënyrë konvencionale krijonte krahasime ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve të tjera, me qëllimin e vetëm, argëtimin e audiencës dhe jo diskriminimin e ndonjë personi”.*

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave i bëri me dije ankuesve se nga shqyrtimi i përmbajtjes audiovizive vlerësoi se puna artistike, krijimtaria, skeçet apo çdo formë arti tjetër argëtues apo humoristik vlerësohej më gjerë: si nga këndvështrimi i lirisë së shprehjes ashtu edhe nga këndvështrimi i lirisë së krijimtarisë, garantuar nga Konventat Ndërkombëtare, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe nga ligji nr. 97/2013 *“Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar.

Nisur nga sa më sipër, Këshilli i Ankesave konstatoi, se përmbajtja për të cilën referohej ankesa nuk binte ndesh me kërkesat e Ligjit nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 60 datë 10.07.2023.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
M.B	Icon Style	Foto	20.05.2024

1. Objekti i Ankesës

M. B i dërgoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) me pretendimin se: *“Icon Style ... ka shitur për ekskluzive një foto që është marrë nga accounti im i Instagramit i cili është privat”*.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesave, Këshilli i Ankesave informoi se kërkesa ishte jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, veprimtaria e të cilit bazohet në Ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Referuar këtij ligji, neni 2 “Fushë e zbatimit” saktëson se *“ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar”*.

Edhe pas ndryshimeve të fundit, të Prillit 2023, konkretisht me ligjin nr.30/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar mediat online vijojnë të jenë jashtë objektit të veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A. H	TV Klan	Stop	11.06.2024

1. Objekti i Ankesës

Shtetasja A.H i nisi një ankesë, Këshillit të Ankesave në lidhje me emisionin “Stop”, transmetuar në televizionin “Klan”, më datë 30.03.2023 deri më 30.05. 2024 në orën 20:05. Ankuesi pretendonte, se:

- *drejtuesi i emisionit “Stop”, S.K, kishte manipuluar faktet dhe duke përdorur eklektika juridike dhe ofruar një emision televiziv me të pavërteta.*
- *më 30.04.2024 rindërtuan një kronikë televizive ku deklaruan se Prokurori i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka marrë para nga noteria A. H”.*

2. Administrimi i Ankesës

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave evidentoi se njëra nga përmbajtjet e referuara ankuesja ishte jashtë afateve ligjore për trajtimin e saj, bazuar në nenin 52 “Shqyrtimi i ankesave”, i ligjit nr.97/2013, i ndryshuar. Sakaq, gjatë shqyrtimit të materialit audioviziv, emisioni “Stop”, transmetuar në televizionin “Klan”, më datë 30 Maj 2024, konstatoi se:

- në orën 20:42:51, kishte vijuar trajtimi i denoncimeve të ardhura nga qytetarët në lidhje me veprimtarinë tuaj e noteres, A. H.
- *qasja, trajtimi dhe interpretimi i fakteve nga ana e formatit investigativ dhe gazetares ishin pjesë e kompetencave editoriale të medias dhe lirisë profesionale të gazetarit dhe për pasojë në mbrojtjen e ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas të cilit “veprimtaria e transmetimeve audiovizive është e lirë” (neni 4, pika 1/a)”.*

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave i bëri me dije ankueses se pretendimet dilnin jashtë përmbajtjes audiovizive të transmetuar nga OSHMA. Referuar ligjit për mediat audiovizive dhe kompetencave që jep Autoritetit, Këshilli i Ankesave refuzoi ankesën.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E. K	TV Klan	Stop	18-19.06.2024

1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave i mbërriti një ankesë nga shtetasi E. K me pretendimin se në emisionin “Stop”, transmetuar në televizionin “Klan”, më datë 02.11.2023 si dhe 16.05.2024 në orën 20:05, ishte transmetuar përmbajtje audiovizive ku E.K ishte etiketuar si “*mashtrules, përvetësues dhe shkatërrues i pronave të tjerëve*” dhe se “*drejtuesit e emisionit ushtronin presion mbi palët të cilët pjesë të procesit*”.

2. Administrimi i Ankesës

Ankuesi referonte në ankesën e tij, përmbajtjet e transmetuara konkretisht në dt. 02.11.2023 si dhe dt.16.05.2024. Në lidhje me transmetimin e datës 02.11.2023 nuk mund të shqyrtohej nga Këshilli i Ankesave, referuar nenin 52 të Ligjit nr.97/2013 “Shqyrtimi i ankesave”, pika 2 përcakton se “Ankesa duhet të paraqitet në formë të shkruar në Këshillin e Ankesave brenda 30 ditëve nga data e transmetimit, ose kur në rastin e dy ose më shumë transmetimeve të lidhura me njëra-tjetrën, nga data e transmetimit më të vonë”. Bazuar në dispozitën ligjore të sipërpërmendur dhe në kuadër të administrimit, Këshilli shqyrtoi përmbajtjen audiovizive të emisionit “Stop”, transmetuar në televizionin “Klan”, më datë 16 Maj 2024, prej nga rezultoi:

- *përkundrejt pretendimeve të ankuesit, ai ishte pyetur nga gazetari i emisionit “Stop” lidhur me çështjen në fjalë, duke respektuar kështu nenin 33, pika 1/b) “Parimet themelore”, i*

ligjit nr.97/2013 i cili përcakton se: "...çështjet që janë tema të debatit publik, duhet të jetë i drejtë për të gjitha subjektet e interesuara".

** qasja, trajtimi dhe interpretimi i fakteve nga ana e formatit investigativ dhe gazetarit janë pjesë e kompetencave editoriale të medias dhe lirisë profesionale të gazetarit dhe për pasojë në mbrojtjen e Ligjit Nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, sipas të cilit "veprimtaria e transmetimeve audiovizive është e lirë" (neni 4, pika 1/a).*

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në vijim të trajtimit të ankesës dhe pretendimeve të ankuesit, për shpifje të bëra nga drejtuesi i emisionit "Stop", Këshilli i Ankesave sqaroi se shpifja nuk trajtohej nga dispozitat ligjore, tagër i Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
I. Ç	Media	Reklamë	13.06.2024

1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave i mbërriti një ankesë nga shtetasi I. Ç me pretendimin se disa media, transmetonin një reklamë për llogari të një kompanie farmaceutike, përmbajtja e së cilës ishte imazhi i tij, të paautorizuar.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadër të administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave i kërkoi Bordit të Shqyrtimit të Ankesave pranë OSHMA-ve marrjen e masave. Bordi i TV Klan njoftoi Këshillin e Ankesave, mbi heqjen e këtij transmetimi nga rrjeti.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
V. M	Report TV	Pa gjurmë	21.06.2024

1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave i mbërriti një ankesë nga shtetasja V. M me pretendimin se në emisionin "Pa gjurmë", transmetuar në televizionin "Report TV", më datë 14.06.2024, ishte transmetuar intervista e babait të saj, P. M, teksa ishin publikuar foto dhe të dhëna personale. Ankuesja pretendonte se kishte kontaktuar edhe me OSHMA-në, duke i bërë prezent shqetësimin, por nuk kishin reaguar.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave i kërkoi Bordit të Shqyrtimit të Ankesave pranë OSHMA-së “Report TV”, paraqitjen e pretendimeve lidhur me ankesën. Në kthim përgjigjen e tyre, OSHMA-ja, bëri me dije se emisioni ishte hequr nga kanali i YouTube i Report TV.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Para vendimmarrjes së tij, Këshilli i Ankesave kreu verifikimet, prej nga ku rezultoi se përmbajtjet audiovizive ishin hequr, konform detyrimeve ligjore të parashikuara në Ligjin Nr.97/2013. Në lidhje me praktikën e administrimit të ankesës dhe përfundimet, u njoftua edhe ankuesja.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
F.T/E.M/L.T	TV Klan	Stop	24.06.2024

1. Objekti i Ankesës

Familjarët e L.T (F.T, E.M, L.T) i drejtuan një ankesë Këshillit të Ankesave me pretendimin se në emisionin “Stop”, transmetuar në televizionin “Klan”, në datat 22.05.2024 & 28.05.2024, ishte transmetuar një përmbajtje audiovizive, me informacione në cenim të drejtës për jetë private dhe familjare.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave shqyrtoi përmbajtjet audiovizive të emisionit “Stop”, transmetuar në televizionin “Klan”, në datat 22 dhe 28 Maj 2024, duke konstatuar se:

- në dy emisione “Stop”, ishte publikuar rasti i abuzimit të dyshuar të një vajze, të dyshuar si person me aftësi të kufizuar.
- qasja, trajtimi dhe interpretimi i fakteve nga ana e formatit investigativ dhe gazetarëve janë pjesë e kompetencave editoriale të medias dhe lirisë profesionale të gazetarit dhe për pasojë në mbrojtjen e ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas të cilit “veprimtaria e transmetimeve audiovizive është e lirë” (neni 4, pika 1/a).
- Kodi i Transmetimit, akt nënligjor, i miratuar me vendimin nr.60 dt.10.07.2023, Seksioni 2 “E drejta për privatësi dhe mbrojtje të të dhënave personale”, pika 2.3 përcakton se: “Shpërndarja e informacionit të publiku, përfshirë fotografi apo pamje nga jeta private pa pëlqimin e personit të prekur, është e pranueshme vetëm nëse interesi publik tejkalon të drejtën e tij për privatësi dhe/ose mbrojtjen e të dhënave personale”.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në vendimmarrjen t tij, Këshilli i Ankesave vlerësoi se përmbajtja audiovizive ishte konform pikës 2.11, të Kodit të Transmetimit, sipas të cilit: *“OSHMA-të duhet të respektojnë parimin e prezumimit të pafajësisë, derisa personi të jetë dënuar me një vendim të formës së prerë. Kjo nuk duhet të pengojë OSHMA-të të raportojnë profesionalisht duke respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë për çështjet me interes publik”*. Kjo deklarohet edhe nga drejtuesi i emisionit, datë 28.05.2024, z. K, i cili në respektim të prezumimit të pafajësisë, për personin ndaj të cilit rëndonin akuzat, në rast provash të tjera, do të bëheshin publike.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
KMD	RTSH 1	Jetë shqiptare	26.06.2024

1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti një ankesë nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përmes së cilës përcillej kwrkesw-ankesa e A. L. Ankuesja pretendonte se *“emisioni “Jetë shqiptare”, transmetuar në televizionin publik RTSH, po e përdor tragjedinë e vetëvrasjes së vajzës së saj A.L, për qëllime mediatike...”*. Sipas KMD-së: *“Ankuesja ... i është drejtuar me kërkesë Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH...për marrjen e masave ...por pa rezultat ”*.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadrin e administrimit të ankesë, Këshilli i Ankesave i kërkoi Bordit të OSHMA-së, RTSH-së, paraqitjen e pretendimeve të tyre, në lidhje me ankesën. Operatori Mediatik Audioviz nuk iu përgjigj kërkesës së KA/AMA-s.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga shqyrtimi i materialit audioviziv dhe pas përfundimit të procedurave administrative të ankesës, Këshilli i Ankesave konstatoi se OSHMA-ja nuk i kishte përmbushur detyrimet, sipas pikës 6 dhe 7 të nenit 53 të ligjit nr. 97/2013 *“Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar. Referuar nenit 53, pika 14 të Ligjit nr.97/2013 *“Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, Këshilli i Ankesave, propozoi vendosjen e sanksionit gjobë në masën 300 000 (treqind mijë) lekë sipas nenit 133, pika 6 të ligjit Nr.97/2013 *“Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar.

ANKESA ME OBJEKT “CENIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE”

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
ASHMDF	Euronews Albania	Edicion Informativ	11.01.2024

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në lidhje me publikimin e lajmit të abuzimit të një vajze të mitur 12 – vjeçare në Pogradec “... në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së fëmijëve. Është intervistuar me zë dhe figurë nëna e vajzës 12 - vjeçare të abuzuar, duke bërë të mundur identifikimin e saj indirekt në media, në cënim të të drejtave të fëmijës. Gjatë intervistës janë publikuar të dhëna dhe detaje të abuzimit që çojnë në dëmtimin e dinjitetit të vajzës 12-vjeçare të abuzuar”.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të adminstrimit të ankesës, pas verifikimeve të kryera lidhur me raportimin mediatik të rastit të abuzimit të dyshuar seksual të së miturës 12-vjeçare në Pogradec, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s nuk konstatoi identifikim të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë të 12 – vjeçares së dyshuar të abuzuar në trasmetimet audiovizive të monitoruara në datat përkatëse në zbatim të

- Ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas të cilit:
 - “veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton në mënyrë të vecantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve”. (Neni 4, “Parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive”, pika 1/b),
 - “në programet e transmetuara nga OSHMA-të të mos cënohet e drejta e fshehtësisë së jetës private të personit”. (Neni 46, “Kodi i Transmetimit”, pika 2/ç),

si edhe

- Të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60, datë 10.07.2023, sipas të cilit:

“Veprimtaria e transmetimeve audio dhe audiovizive respekton, mbron dhe promovon të drejtat e fëmijës, mirëqenien, shëndetin, zhvillimin harmonik moral dhe fizik të tij. Parimi i interesit më të lartë të fëmijës duhet të jetë parësor në çdo vendimmarrje për programimin, transmetimin, informimin e tyre dhe informacionet për ta”. (Seksioni 1, “Parimet themelore”, pika 1.4).

“Veprimtaria e transmetimeve audio dhe audiovizive respekton, mbrohet dhe promovon të drejtat e fëmijës, mirëqenien, shëndetin, zhvillimin harmonik moral dhe fizik të tij. Parimi i interesit më të lartë të fëmijës duhet të jetë parësor në çdo vendimmarrje për programimin, transmetimin, informimin e tyre dhe informacionet për ta”. (Seksioni 4, “Fëmijët në transmetimet audio dhe audiovizive”, në nënseksionin “Ndalimi i identifikimit të fëmijës” , pika 4.24).

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Sa më sipër, duke vlerësuar ruajtjen e standarteve profesionale të raportimit korrekt të lajmit në subjektin audioviziv, Euronews Albania, të monitoruar nga AMA, në emër të interesit më të lartë të fëmijës, Këshilli i Ankesave i dërgoi një shkresë sensibilizuese operatorit përkatës të reflektonte të njëjtat standarte edhe në llogarinë e tij në You Tube duke hequr videon përkatëse!

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Vetë-inicim	Fax News ABC News MCN TV TV News 24 Ora News Syri Tv Report Tv Vizion Plus	Edicion Informativ	11.01.2024

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) pas një ankese të mbërritur nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në lidhje me publikimin e abuzimit të dyshuar seksual të një miture në Pogradec, verifikoi raportimin mediatik të rastit në fjalë.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadrin e verifikimeve të kryera në lidhje me raportimin e abuzimit të dyshuar seksual të së miturës në Pogradec, Këshilli i Ankesave konstatoi se :

Në edicionet informative të subjekteve audiovizive (Fax News, ABC News, MCN TV, News 24, Ora News, Syri TV;

- ishin publikuar të dhëna rrethanore që çojnë në identifikimin e viktimës së dyshuar, (fshati ku ka ndodhur ngjarja),

- ishte transmetuar intervista me zë dhe figurë të mamasë së vajzës, duke mundësuar identifikimin direkt të miturës,
- ishte transmetuar intervista me zë dhe figurë e babait të abuzuesit të dyshuar, duke mundësuar identifikimin indirekt të tij.

Për rrjedhojë, Këshilli i Ankesave konstatoi shmangie :

- nga ligji nr.97/2013 *“Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, sipas të cilit:
 - o *“veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve”*. (Neni 4, *“Parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive”*, pika 1/b),
 - o *“në programet e transmetuara nga OSHMA-të të mos cenohet e drejta e fshehtësisë së jetës private të personit”*. (Neni 46, *“Kodi i Transmetimit”*, pika 2/ç),

si edhe

- nga Kodi i Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60, datë 10.07.2023, sipas të cilit:

“Veprimtaria e transmetimeve audio dhe audiovizive respekton, mbron dhe promovon të drejtat e fëmijës, mirëqenien, shëndetin, zhvillimin harmonik moral dhe fizik të tij. Parimi i interesit më të lartë të fëmijës duhet të jetë parësor në çdo vendimmarrje për programimin, transmetimin, informimin e tyre dhe informacionet për ta”. (Seksioni 1, *“Parimet themelore”*, pika 1.4).

“Veprimtaria e transmetimeve audio dhe audiovizive respekton, mbron dhe promovon të drejtat e fëmijës, mirëqenien, shëndetin, zhvillimin harmonik moral dhe fizik të tij. Parimi i interesit më të lartë të fëmijës duhet të jetë parësor në çdo vendimmarrje për programimin, transmetimin, informimin e tyre dhe informacionet për ta”. (Seksioni 4, *“Fëmijët në transmetimet audio dhe audiovizive”*, në nënseksionin *“Ndalimi i identifikimit të fëmijës”*, pika 4.24).

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nisur nga sa më sipër, Këshilli i Ankesave, bazuar në *“Rregulloren për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtën e përgjigjes”*, e ndryshuar me vendimin e AMA-s, nr.56, datë 07.07.2023, neni 6 *“Konkluzionet e Këshillit të Ankesave”*, pika 4, i tërhoqi vëmendjen operatorëve përkatës për shmangie nga ligji nr.97/2013 *“Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar dhe Kodi i Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60, datë 10.07.2023 dhe i kërkoi ndalimin e ritransmetimit të publikimit në fjalë si dhe heqjen e videove përkatëse nga kanali zyrtar në YouTube brenda një afati prej 30 ditësh duke i kujtuar se në rast të kundërt do të procedohej sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Gjithashtu, edhe pse nuk konstatoi shmangie nga ligji nr.97/2013 *“Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar dhe nga Kodi i Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60, datë 10.07.2023 në raportimin mediatik të ngjarjes nga operatorët audiovizivë TV Klan dhe Euronews Albania, Këshilli i Ankesave, në emër të interesit më të lartë të fëmijës u bëri

thirrje atyre të reflektonin të njëjtat standarde profesionale edhe në llogaritë e tyre në You Tube, duke hequr videon përkatëse.

Paralelisht me tërheqjen e vëmendjes së OSHMA-ve, nisur nga fakti, se si burim i parë i të dhënave rrethanore dhe shoqërore, që zbulojnë identitetin e të prekurve, shërben njoftimi i Policisë së Shtetit, në kuadrin e “Sistemit të integruar të mbrojtjes” dhe “Interesit më të lartë të fëmijës” sipas frymës së ligjit “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) i drejtoi një shkresë sensibilizuese edhe Policisë së Shtetit përmes së cilës i solli në vëmendje :

- për të mos publikuar “të dhënat personale të fëmijës gjatë zhvillimit të procedurave administrative e gjyqësore” (Neni 29/Pika 6) si edhe
- detyrimin e agjencive ligjzbatuese për të mos publikuar “asnjë informacion, që mund të çojë në identifikimin e të miturit ... viktimë ose dëshmitar të një veprë penale” (Ligji 37/2017, Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, Neni 21/Pika 2).

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
ASHMDF	Vizion Plus & Media të tjera	Edicion Informativ	17.02.2024

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, me objekt “*raportimin mediatik të arrestimit të gjyshes dhe babait të një fëmije 10 vjeç, i cili dyshohej se shfrytëzohej, për përfitime, në rrjetin social “Tik Tok”*”.

2. Administrimi i Ankesës

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave nisi verifikimet lidhur me pasqyrimin e përgjithshëm mediatik të ngjarjes nga OSHMA-të. Në kuadrin e administrimit të rastit, Këshilli i Ankesave këqyri me vëmendje përmbajtjet audiovizive, nga *edicionet informative e deri tek emisionet e transmetuara* prej OSHMA-ve, nga ku evidentoi shmangie prej:

Ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në:

· nenin 4, pika 1/b; neni 46, pika 2/ç).

dhe

Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60, datë 10.07.2023, në:

· seksionin 1, pika 1.4, seksionin 4, pika 4.24.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Për sa më sipër, Këshilli i Ankesave, bazuar në “Rregulloren për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtën e përgjigjes”, e ndryshuar me vendimin e AMA-s, nr.56, datë 07.07.2023, neni 6 “Konkluzionet e Këshillit të Ankesave”, pika 4, i tërhoqi vëmendjen operatorëve audiovizivë:

Top Channel, Vizion Plus, Fax News, News 24, Abc News, Ora News, Syri TV, MCN TV, RTSH, TV Klan, Klan Plus

për shmangie nga ligji nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Kodi i Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60, datë 10.07.2023 dhe i kërkoi heqjen e videos përkatëse prej llogarisë së tyre në Youtube brenda një afati prej 30 ditësh.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Disa ankues	Top Channel	Fun Club	27.03.2024

1. Objekti i Ankesës

Pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mbërritën disa ankesa me pretendimin se në emisionin “Fun Club”, transmetuar në televizionin Top Channel “*ishte intervistuar vajza e njëjës prej banorëve të “Big Brother” me zë dhe me fytyrë, pa informacion për procedurat e miratimit të prezencës së të miturës në një emision televiziv, në kushtet kur e ëma ndodhej në “Big Brother”*”. Ankuesit pretendonin se “*e mitura kishte folur për jetën private dhe marrëdhëniet personale me babain dhe nënën...*”.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadrin e administrimit të ankesës, referuar nenit 51 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes”, si dhe udhëzimit “Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv”, Këshilli i Ankesave i kërkoi Bordit të Shqyrtimit të Ankesave pranë televizionit Top Channel paraqitjen e pretendimeve lidhur me ankesën e sipërcituar.

Në përgjigjen e vet, Top Channel shprehej se “intervista ishte marrë si pasojë e dëshirës për t’i bërë një surprizë nënës së saj. Përpara zhvillimit të intervistës ish-konkurrentja është pyetur në dhomën e rrëfimit nëse vajza mund të intervistohej dhe ka dhënë pëlqimin e saj verbal për zhvillimin e intervistës”.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Sa më sipër, Këshilli i Ankesave konstatoi se përmbajtja audiovizive e mësipërme nuk binte ndesh me kërkesat e Ligjit Nr. 97/ 2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë” dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 60 datë 10.07.2023

ANKESA JASHTË JURIDIKSIONIT

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
K.C		“Nëntori i dytë”	03.01.2024

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga shtetasi K.C në datën 03.01.2024 me pretendimin se filmi “Nëntori i Dytë”, realizuar gjatë periudhës së regjimit diktatorial “ *jo vetëm nuk është i mbështetur në fakte historike të vërteta, por është i ndikuar nga fenomene të artit socialist të kohës, me konotacione negative për këtë ngjarje historike...*”.

Sipas ankuesit “...skenari i filmit...ka kaluar në shtrembërime dhe madje mashtrime me të vërtetat e ngjarjeve dhe aktorëve historikë”.

1. Administrimi i Ankesës dhe qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Duke vlerësuar dhe mirëkuptuar maksimalisht shqetësimin e tij, ankuesit iu bë me dije se kauza në fjalë edhe më herët kishte tërhequr vëmendjen e Autoritetit të Mediave Audiovizive ndërsa kjo temë është diskutuar edhe në një prej takimeve të AMA-s (2017) me përfaqësues të Institutit të Integritetit të ish të Përndjekurve Politikë në Tiranë.

Pas konsultimeve është rënë dakord se nevojitet të bëhet një vlerësim i krijimtarisë filmike dhe dokumentare të periudhës së para viteve '90 dhe së dyti duhet një vendimarrje për mënyrën e transmetimit publik të saj.

Në kuadrin e administrimit të ankesës, ankuesi u informua se AMA është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe se shqetësimi i tij nuk lidhet me produkte audiovizive të televizioneve por me vepra kinematografike që janë prodhuar në një kontekst tjetër.

Për rrjedhojë, vendimi dhe vendimarrja janë dy procese që e tejkalojnë kompetencën ligjore dhe rregullative të AMA-s.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
SCiDEV			04.01.2024

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një kërkesë për informacion nga Qendra Shkëncë dhe Inovacion për Zhvillim në lidhje me gjobat e vendosura ndaj OSHMA-ve gjatë vitit 2023 dhe motivacionet e tyre nga Autoriteti i Mediave Audiovizive

(AMA). Organizata ishte gjithashtu e interesuar për ndryshime të mundshme ligjore të parashikuara në Ligjin nr. 97/ 2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Administrimi i Ankesës

Pas marrjes së kërkesës për informacion Këshilli i Ankesave i vuri në dispozicion ankuesit propozimin e vet për vendosjen e sanksioneve financiare me gjobë në 6 raste per vitin 2023, propozime të cilat kanë marrë edhe miratimin e Bordit të AMA-s.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.K	“Facebook”		17.01.2024

1. Objekti i ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga shtetasja A.K, me objekt “*Marrjen e masave për fshirjen e kronikës prodhuar nga emisioni Xhadat pranë MCN televizion dhe gjobitjen e pronarit të këtij televizioni për këtë kronikë sipas dispozitave ligjore*”, ku ajo pretendonte se :

- në rrjetin e tij në FB, shtetasi Endri Mexi publikoi një video të përgatitur nga emisioni “Xhadat”, pranë MCNTV, duke referuar rrjetin social Facebook.
- shihej lehtësisht përpjekja e tij për ta denigruar dhe fyer botërisht, duke përdorur valët kombëtare të një televizioni për sulme personale... .

2. Administrimi i Ankesës dhe qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Duke mirëkuptuar maksimalisht shqetësimin e saj, ankuses iu bë me dije se pretendimi referuar rrjetit social “Facebook” është jashtë objektit të veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive i cili është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve audio dhe audiovizive në territorin e Republikës së Shqipërisë, veprimtaria e të cilit bazohet në ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili ka për “Fushë e zbatimit” (neni 2), “transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre.”

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
TKOBAP	TV Klan	Emisioni ”Stop”	17.01.2024

1. Objekti i ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga Drejtoresha e Përgjithshme e Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor,

Znj.Abigeila Voshtina, me objekt “Kërkesë për marrjen e masave që parashikon ligji ndaj emisionit “Stop”, për hyrjen me dhunë në TKOBAP, më datë 10 Janar 2024”, ku pretendonte se:

- më datë 10 janar 2024, një ekip xhirimi i emisionit “Stop”, kishte mësyre dyert e institucionit, pa njoftuar paraprakisht për intervistë, pa ndjekur procedurën ligjore të kërimit të informacionit,
- gazetarja Domenika Bajraktari, bashkë me operatorin e këtij emisioni kishte hyrë me forcë në institucion,
- me një gjuhë aspak etike, një komunikim ofendues dhe duke provokuar dhe fyer stafin, ajo kishte penguar mbarëvajtjen e punës dhe terrorizuar stafin e TKOBAP,
- pamjet filmike të sigurisë së institucionit, procesverbalin e mbajtur për këtë rast, si dhe shkresën dërguar emisionit “Stop”, për pretendimet e tyre.

2. Administrimi i Ankesës dhe qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadrin e administrimit të pretendimeve të saj, ankuesja u informua se, AMA, në cilësinë e vet si autoritet i pavarur rregullator, në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë, vepron në bazë e për zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 97/2013, të ndryshuar, si dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Sipas dispozitave të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 2 “Fusha e zbatimit”, përcakton se “Ky ligj zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre”. Pra, Autoriteti është përgjegjës për monitorimin e transmetimeve audiovizive lineare, transmetimeve audiovizive jolineare dhe shërbimeve mbështetëse të tyre, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove.

Për rrjedhojë, aspekti i “marrjes së masave ndaj emisionit “Stop” për hyrjen me dhunë në TKOBAP” është jashtë kompetencave ligjore të AMA-s dhe nuk është objekt trajtimi prej tij.

AMA është autoritet rregullator, veprimtaria dhe kompetencat vendimmarrëse të të cilit përcaktohen nëpërmjet dispozitave të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ky ligj, apo edhe aktet nënligjore të dala për dhe në zbatim të tij, nuk parashikojnë ndërhyrjen e Autoritetit në pretendime që dalin nga materiale të pa transmetuara në median audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
“Vish këpucët e mia”	Top Channel	“Big brother vip”	30.01.2024

1. Objekti i ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga organizata “Vish këpucët e mia” përmes së cilës shprehej shqetësimi se “*në emisionin “Big Brother Vip”, transmetuar në televizionin Top Channel, gjatë transmetimit, një anëtar i programit (Gazi), përdori gjuhë urrejtje duke përdorur fjalë që nxisin diskriminimin dhe rrisin stereotipet e shikuesve për komunitetin rom...*”

2. Administrimi i Ankesës

Nga verifikimet e kryera pas marrjes së shkresës, Këshilli i Ankesave nuk konstatoi transmetimin e materialit në datën dhe orën e referuar nga ankuesi në subjektin audioviziv Top Channel.

Ankuesit ju bë me dije se, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) shqyrton çdo ankesë, lidhur me transmetimin e lajmeve dhe programeve në shkelje të kërkesave të nenit 33 të ligjit nr. 97/2013, “*Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar **në bazë të një formulari ankese** i cili përcakton saktësisht **subjektin audioviziv** ku është transmetuar materiali si dhe **datën** dhe **orën** e saktë të **transmetimit**.

Sa më sipër, ankuesit ju kërkua të specifikonte **saktësisht** subjektin audioviziv, datën dhe orën e saktë të materialit audioviziv për të cilin ankohej, në mënyrë, që ankesa të vijonte trajtimin e saj!

Organizata “Vish këpucët e mia” i dërgoi një tjetër shkresë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku bashkëlidhte videon të cilën, sipas tyre, “e kishin shkarkuar në platformën youtube të organizatës “Vish këpucët e mia”, me qëllim përdorimin nga autoriteti i AMA-s”. Ankuesi pretendonte se video në fjalë ishte publikuar nga disa rrjete sociale, (Tik Tok, olsikshugjonash) me qëllim raportimin e gjuhës së urrejtjes.

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) pasi mori në shqyrtim ankesën e dytë nga organizata “Vish këpucët e mia”, përmes së cilës na informonin se kishin dërguar “*videon të cilën e kemi shkarkuar në platformën You Tube të organizatës..., me qëllim përdorimi nga autoriteti*” - dhe se – “*Kjo video është publikuar nga disa rrjete sociale*”, si edhe në komunikimet e mëparshme, e sqaroi ankuesin se:

Nga verifikimet e kryera, Këshilli i Ankesave nuk konstatoi transmetimin e materialit, për të cilin ai ankohej, në subjektin audioviziv Top Channel, në orarin dhe datën e referuar”.

Pra, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s e ka administruar çështjen, duke e trajtuar atë sipas të gjitha dispozitave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe aktet nënligjore përkatëse.

Në lidhje me materialin e referuar “*video publikuar nga disa rrjete sociale*”, ankuesit ju bë me dije se bazuar në dispozitat e ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 2 “Fusha e zbatimit”, përcakton se “Ky ligj zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre”, për sa kohë përmbajtja është publikim në **rrjetet sociale**, është jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Për rrjedhojë administrimi i ankesës së mësipërme për sa kohë u referohej rrjeteve sociale ishte jashtë kompetencave të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Pas insistimit të vazhdueshëm të ankuesit, përmes një tjetër email-i, mbërritur në postën elektronike të Autoritetit të Mediave Audiovizive në datën 15 Shkurt 2024, ku pretendohet se “...video është pjesë e transmetuar në TV Top Channel”, Këshilli i Ankesave verifikoi rastin duke konstatuar, se përmbajtja nuk ishte transmetuar në Top Channel, këqyri më pas përmbajtjen audiovizive edhe në kanalet me pagesë të “DigitAlb”, “Big Brother 1” dhe “Big Brother 2” të datës 21 Janar 2024 dhe konstatoi se videoja ishte sekuenca nga emisioni “Big Brother” transmetuar në “DigitAlb”, në kanalën me pagesë “Big Brother 2”.

Nga verifikimi i përmbajtjes audiovizive, Këshilli i Ankesave e gjeti atë në shmangie të Ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si edhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, nr. 60, datë 10.07.2023.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Për sa më sipër, Këshilli i Ankesave **i tërhoqi vëmendjen** subjektit audioviziv “DigitAlb”, për shmangie nga ligji nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Kodi i Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60, datë 10.07.2023 si dhe i kërkoi **ndalimin e publikimit të videos në kanalën zyrtar në YouTube duke e paralajmëruar** se çdo përsëritje do të trajtohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Ministria e Mbrojtjes	Zëri.al		09.02.2024

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes pranë Ministrisë së Mbrojtjes, me objekt “Ankesë për portalin “Zëri.al”, në lidhje me një koment abuziv, tendencioz dhe dezinformues mbi një foto të personelit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes të atashuar me mision në kuadër të NATO-s, KFOR, Kosovë nga portali “Zëri.al”.

Ankuesi pretendonte që portali “Zëri.al” të mbante përgjegjësi me pretendimin se “kishte shkelur pikën 1/a të nenit 33 të ligjit nr.97/2013, duke transmetuar informacion të pavërtetë”.

2. Administrimi i Ankesës dhe qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadrin e administrimit të pretendimeve të mësipërme, e informuam ankuesin se , AMA, në cilësinë e tij si autoritet i pavarur rregullator, në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë, vepron në bazë e për zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 97/2013, të ndryshuar, si dhe legjisllacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Sipas dispozitave të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 2 “Fusha e zbatimit”, (ndryshuar me ligjin nr. 30/2023, datë 13.4.2023), përcakton se “Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar.”.

Pra, Autoriteti është përgjegjës për monitorimin e transmetimeve audiovizive lineare, transmetimeve audiovizive jolineare dhe shërbimeve mbështetëse të tyre, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove. Për rrjedhojë, ankuesit iu bë me dije se “marrja e masave ndaj portali “Zëri.al” është jashtë kompetencave ligjore të AMA-s dhe nuk është objekt trajtimi prej tij.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.K	Portalet Online		16.02.2024

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga shtetasi A.K përmes së cilës ankuesi shprehimisht kërkonte “të merreshin masa ... kundrejt disa portaleve për heqjen e një lajmi...ku akuzohej padrejtësisht për një vepër penale të cilën nuk e kishte kryer, duke i dëmtuar privatësinë dhe shkaktuar dëme të mëdha... si edhe të hiqej emri i tij nga portalet... dhe motorri i kërkimit në Google”.

2. Administrimi i Ankesës dhe qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pasi mori në shqyrtim kërkesën në fjalë, duke vlerësuar dhe mirëkuptuar maksimalisht shqetësimin e ankuesit, Këshilli i Ankesave e informoi atë, se ligji nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 2, “Fusha e zbatimit”, (ndryshuar me ligjin nr. 30/2023, datë 13.4.2023), përcakton se “Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove...”.

Nga shqyrtimi i listës së portaleve, që ankuesi vuri në dispozicion, rezultonte, se vetëm njëri prej tyre (<https://top-channel.tv/video/te-arrestuarit-per-korrupsion-ne-universitetin-e-elbasanit-nji-hen-me-masat-e-sigurise/>) paraqiste në vetvete shërbim mbështetës të një Ofruesi Shërbimi Mediatik Audioviziv, konkretisht të TOP Channel. Nisur nga ky fakt, Këshilli i Ankesave – duke mirëkuptuar shqetësimin e tij, pavarësisht se ligji për këtë parashikon një afat prej 30 ditësh - iu drejtua TOP Channel, duke i bërë thirrje për heqjen e videos përkatëse nga llogaria e tij në YouTube.

Portalet e tjera, të listuara prej ankuesit, si edhe motori i kërkimit Google, ishin jashtë fushës së veprimit dhe kompetencave ligjore të AMA-s.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.K	RTSH 22	“Dosjet e hapura”	23.02.2024

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga shtetasi E.K me objekt *“në lidhje me Gabimin e Qëllimshëm të cilin e ka bërë Televizioni Publik Shqiptar...më datë 22 maj 2023 në YouTube (emisioni quhet “Dosjet e hapura”)*”.

Ankuesi pretendonte se në dokumentarin e transmetuar në RTSH HD1, me titull *“Kush ishte koloneli që iu bënë 8 atentate dhe u vra në janarin e 2003”*, ishte *“postuar një dokument konfidencial ... duke e rrezikuar atë personalisht dhe familjen e tij prej 5 anëtarësh”*, dhe kërkonte marrjen e masave nga Autoriteti i Mediave Audiovizive.

2. Administrimi i Ankesës dhe qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadrin e administrimit të ankesës dhe pretendimeve të ankuesit, atij ju bë me dije se :

- Bazuar në ligjin nr. 97/2013, *“Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, konkretisht nenit 52, *“Shqyrtimi i ankesave”*, *“Ankesa duhet të paraqitet në formë të shkruar në Këshillin e Ankesave brenda 30 ditëve nga data e transmetimit, ose në rastin e dy ose më shumë transmetimeve të lidhura me njëri-tjetrin, nga data e transmetimit më të vonë”*.

Bazuar në dispozitën ligjore të sipërcituar përmbajtja audiovizive, së cilës ankuesi i referohej nuk mund të ishte objekt shqyrtimi, pasi ishte jashtë afateve ligjore të parashikuara.

- Sa i takon platformës së shpërndarjes së videove “YouTube”, kompetencat, që ligji nr. 97/2013, *“Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar (edhe me ligjin nr. 30/2023) i jep AMA-s si autoritet rregullator, tëjtat kompetenca, që prekin veprimtarinë audiovizive të OSHMA-ve dhe/ose të PSV-ve.

Konkretisht, neni 2 i ligjit parashikon se objekt zbatimi i tij janë transmetimet audiovizive lineare (të transmetuara në kohe reale), transmetimet audiovizive jolineare (video-on-demand), shërbimet mbështetëse të tyre, si dhe shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove. Në këtë kuadër, afati i personit të interesuar për të paraqitur ankesë, në kuptim të nenit 51 të ligjit, fillon nga momenti i transmetimit/shfaqjes/hedhjes së parë të përmbajtjeve audiovizive në çdo rast. Veprimi i transmetimit/shfaqjes/hedhjes, në kuptimin e ligjit, ka të bëjë me subjektin, që e ofron shërbimin apo përmbajtjen dhe jo me subjektin, që e percepton apo konsumon atë. Për pasojë edhe afatet e transmetimit/shfaqjes/hedhjes kanë të bëjnë vetëm me subjektin, që e ofron shërbimin apo përmbajtjen dhe jo me subjektin, që e percepton apo konsumon atë.

Bazuar në sa më sipër, ankuesi u informua se Autoritetit i mungonte hapësira ligjore për administrimin e ankesës së tij.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Q.P	Portalet Online		27.02.2024

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga shtetasi Q.P përmes së cilës ankuesi pretendonte për mungesën e autorësisë në një shkrim të publikuar në portalin e një OSHMA-je kombëtare.

2. Administrimi i Ankesës dhe qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadër të administrimit të ankesës, ankuesit ju bë me dije sa më poshtë vijon:

- Përmbajtjet e referuara prej tij u takonin dy shkrimeve të gjinisë së fejtimit, të autorit Edison Ypi, të publikuara në rubrikën “Opinion” në faqen zyrtare të Top Channel.
- Emri, mbiemri, fotografia e autorit dhe referencat kohore të publikimit (data dhe ora) ishin pozicionuar qartësisht dukshëm në krye të artikullit, midis titullit dhe trupit të shkrimit.

AMA, si autoritet rregullator, në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive në territorin e Republikës së Shqipërisë, vepron në bazë të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Sipas nenit 2 “Fusha e zbatimit”, (ligji 97/2023, ndryshuar me ligjin nr. 30/2023, datë 13.4.2023), “Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar.”.

Për rrjedhojë, artikujt e publikuar online – edhe pse në faqen zyrtare të një televizioni – janë jashtë fushës së veprimtarisë dhe kompetencave ligjore të AMA-s, ndaj ankesat konkrete ndaj përmbajtjes së tyre nuk mund të trajtohen prej Autoritetit.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Dhjetëra ankues	Top Channel	Big Brother Vip	03.04.2024

1. Objekti i Ankesës

ASHMDF dhe dhjetëra ankues drejtuan një ankesë Këshillit të Ankesave me pretendimin se në emisionin “Big Brother Vip 3”, transmetuar në “Top Channel” njëra prej banoreve të këtij formati, kishte bërë biseda me konotacion seksual kundrejt një të miture, fëmijë i tjetër banori, pjesë e formatit.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive evidentoi mungesën e elementëve të domosdoshëm për vijimin e trajtimit të problematikës, ndaj dhe i kërkoi ankuesve plotësimin e të dhënave në kuadër të administrimit të saj.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Av. E. Gj	Syri TV	Piranjat	19.04.2024

1. Objekti i Ankesës

Përfaqësuesi ligjor, A. Gj i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), me objekt *“publikimin e pamjeve filmike të të miturit E.M nga emisioni “Piranjat”, me pretendimin se pamjet video të të mituri ishin marrë në kushte aspak normale me zë dhe figurë. Ndaj ankuesi kërkonte të mos lejohej publikimi në vijimësi i tyre.*

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadrin e administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave këqyri me vëmendje përmbajtjen audiovizive të emisionit “Piranjat”, transmetuar në televizionin “Syri TV” më datë 19 Prill 2024, në orën 20:45, nga ku evidentoi se:

- *“rubrika “Turpi dhe vajmedeti” (ora 21:29), trajtonte rastin e shantazhimit dhe kërcënimit të një vajze 15 vjeçare, denoncuar nga e ëma, e cila kishte kërkuar ndihmën e medias për denoncimin e rastit,*
- *në bashkëpunim me denoncueset (mamanë dhe vajzën), media i ishte drejtuar Policisë së Shtetit, për mbështetje, në trajtimin e rastit,*
- *paraqitja e të arrestuarit bëhej duke përdorur masa teknike të mbulimit të posaçëm të figurës”.*

2.Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave çmoi se në këtë rast OSHMA-ja kishte zbatuar parimet bazë të zhvillimit të veprimtarisë audiovizive, pasi përtej interesit publik, që paraqet sensibilizimi i opinionit për rrezikun e fokusuar, ishte kujdesur, që përmes përdorimit të teknologjisë së posaçme të mbulimit, të pamundësonte identifikimin e protagonistëve si dhe të mbronte audiencën nga efektet, që programi mund të ketë.

Për rrjedhojë, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, konkludoi, se trajtimi i rastit nga media i shërben informimit të opinionit publik në lidhje me çështje të ndjeshme për interesin publik mbi përdorimin e rrjeteve sociale nga të miturit dhe pasojat në rast keqpërdorimi të tyre.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
ASHMDF	Media	Video	13.05.2024

1. Objekti i Ankesës

Agjencia Shtetërore e Mbrojtjes së Drejtave të Fëmijëve i kërkoi Këshillit të Ankesave mos “transmetimin e videos të nënës dhe fëmijëve të cilët dyshohej se ishin vetë mbytur në Lumin e Bunës...”. Në ankesën e tyre, përfaqësuesit e ASHMDF-së kërkonin shmangien e transmetimit të pamjeve si dhe fshirjen e këtyre videove.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadrin e administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave i këqyri me vëmendje përmbajtjet audiovizive të transmetuara nga OSHMA-të më datë 9 Maj 2024, prej të cilave evidentoi se:

“videoja e nënës me fëmijët, e cila ishte përdorur nga mediat dhe në shërbim të sensibilizimit të dëshmitarëve të mundshëm dhe zbardhjes së mëtejshme të ngjarjes, në vetvete nuk përmbante as dhunë, as skena shqetësuese dhe as identifikim të fëmijëve”.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në vendimmarrjen e tij, Këshilli i Ankesave çmoi se në këtë rast Operatorët e Shërbimit Mediatik Audioviziv kishin ushtruar funksionin parësor të medias, në mbështetje të interesit publik për informimin e lirë të opinionit në lidhje me çështje sensitive që i shërbenin hetimit të gjithanshëm të ngjarjes duke kontribuar në zbardhjen e plotë të saj.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
ASHMDF	Media	Shkrime	22.05.2024

1. Objekti i Ankesës

Agjencia Shtetërore e Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave në lidhje me identifikimin indirekt të një 15- vjeçareje në Kavajë, *“viktimë e abuzimit seksual në familje....përmes publikimit të emrit të plotë të babait abuzues dhe fotografisë së tij, duke dëmtuar rëndë privatësinë dhe konfidencialitetin e vajzës”.*

2. Administrimi i Ankesës

Nga shqyrtimi i përmbajtjes audiovizive dhe verifikimeve të kryera rezultoi se të dhënat identifikuese të babait abuzues, si gjeneralitetet dhe fotografia, ishin publikuar në njoftimin zyrtar të Policisë së Shtetit, i cili kishte shërbyer si burim informacioni për median, duke mundësuar identifikimin e tërthortë të viktimës.

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në mënyrë të përsëritur, ka komunikuar me institucionin e Policisë së Shtetit me shkresa sensibilizuese, në mbrojtje të interesit më të lartë të fëmijës në administrimin e të dhënave rrethanore, që mundësojnë identifikimin e viktimës, duke u rikujtuar:

- *detyrimin mbarëshoqëror “për të mbrojtur në të gjitha situatat privatësinë e fëmijës” (Ligji 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, Neni 17/Pika 2) dhe për të mos publikuar “të dhënat personale të fëmijës gjatë zhvillimit të procedurave administrative e gjyqësore” (Neni 29/Pika 6),*
- *detyrimin e agjencive ligjzbatuese për të mos publikuar “asnjë informacion, që mund të çojë në identifikimin e të miturit ... viktimë ose dëshmitar të një veprë penale” (Ligji 37/2017, Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, Neni 21/Pika 2),*
- *detyrimin e organeve të Policisë së Shtetit, që përpunimin e të dhënave personale ta kufizojë “vetëm në të dhënat e nevojshme për ndalimin e një rreziku real ndaj rendit e sigurisë publike si dhe për parandalimin, zbulimin, ndjekjen dhe hetimin e veprave penale” (Ligji 108/2014 “Për policinë e shtetit”, Neni 124/Pika 1).*

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga monitorimet që Autoriteti i Mediave Audiovizive kreu në lidhje me publikimin e ngjarjes në fjalë rezultoi se pati përmbysje të zhvillimeve, përgënjeshttrim të ngjarjes, për çka Këshilli i Ankesave e konsideroi të mbyllur trajtimin e rastit.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
M. Sh	JOQ TVA News JOQ Tik Tok JOQ News	Lajme	23-25.04.2024

1. Objekti i Ankesës

M. Sh i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) në lidhje me publikimin e disa fotove të tij, shoqëruar me lajme të pavërteta në disa portale, konkretisht nga “JOQ Albania, TVA News, TVA + , JOQ Tik Tok, JOQ News” në datat 09.04.2024, 10.04.2024 dhe 11.04.2024. Ankuesi kërkoi nga Autoriteti i Mediave Audiovizive heqjen e këtyre publikimeve nga portalet e mësipërme dhe marrjen e masave ligjore kundrejt tyre.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga shqyrtimi i materialit, Këshilli i Ankesave evidentoi faktin se kërkesa për heqjen nga këto portale të publikimeve, të cilave u referohej ankesa, binte jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, veprimtaria e të cilit bazohet në Ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili ka për “Fushë e zbatimit” (neni 2), “transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar”. Në zbatim të kësaj dispozite ligjore, AMA shqyrton vetëm ankesat, të cilat i referohen transmetimit të përmbajtjeve audiovizive, në shkelje të ligjit Nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
R.I	Ora News	Shkrim	09.05.2024

1. Objekti i Ankesës

R.I i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) në lidhje me një lajm të publikuar në “websitin e OraNews.tv në datë 26 Prill 2024 ora 13:23 me autor E.Q”. Sipas ankuesit, përmbajtja e shkrimit lidhej drejtpërdrejt me të dhe se gjithçka e shkruajtur ishte e pavërtetë.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së ankesës, konkretisht linku, “<https://www.oranews.tv/vendi/i-hoqen-nga-duart-dy-here-tenderat-dhe-ia-dhuruan-4-a-m-spak-merr-te-pande-i1155690>”, ankuesit iu bë me dije se sipas dispozitave të Ligjit Nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 2 “Fusha e zbatimit”, përcakton se “Ky ligj zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre”.

Bazuar në dispozitën ligjore të sipërpërmendur por edhe ndryshimeve të fundit, të Prillit 2023, konkretisht me ligjin nr.30/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, mediat online, portalet, vijnë të mbeten jashtë objektit të veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive. Po kështu, Këshilli këqyri përmbajtjet audiovizive të transmetuara në 26 Prill 2024 nga televizioni “Ora News” dhe nga verifikimet rezultoi se materiali audioviziv përkatës nuk ishte transmetuar në datën e referuar prej ankuesit.

ANKESA JASHTË AFATI

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A. N	Media	Video	16.05.2024

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) shqyrtoi ankesën e shtetasit A. N me objekt denoncimin e tij, për: *“disinformim dhe përhapjen me qëllim të informacionit të rremë”, përkritazi emisionit “Pa gjurmë”, transmetuar në Report TV, në datat 09.03.2023 & 10.03.2023 ora 16:00”*. Ankuesi pretendonte për *“përhapjen e informacionit të rremë me qëllim...., duke vënë në rrezik jetën e personave”* dhe *“kryerjen e të paktën 5 kundërvajtjeve penale”, si: “regjistrimi i zërit, fiksimi dhe transmetimi pa dhënë pëlqim, deformim informimi...., etj.”*.

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga shqyrtimi i materialit të ankuesit, bazuar në ligjin nr. 97/2013, *“Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, konkretisht neni 52, *“Shqyrtimi i ankesave”*, Këshilli i Ankesave konstatoi se ankesa duhet të ishte paraqitur në formë të shkruar brenda 30 ditëve nga data e transmetimit, ose në rastin e dy ose më shumë transmetimeve të lidhura me njëri-tjetrin, nga data e transmetimit më të vonë. Referuar dispozitës ligjore të sipërcituar përmbajtja audiovizive, së cilës i referohej ankuesi ishte jashtë afateve ligjore të parashikuara. Në lidhje me pretendimet e tij për kundërvajtje penale gjatë zhvillimit të emisionit, iu sqarua se kategorizimi i një veprimi të tillë në vepër penale ose jo, bie jashtë kompetencave të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

TË NDRYSHME

Paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.GJ	Top Channel	“Big Brother Vip”	23.01.2024

1. Objekti

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një shkresë nga shtetasi A.Gj përmes së cilës ai kërkonte informacion nëse Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) kishte vendosur ndonjë gjobë për shkelje të etikës televizive ndaj subjektit audioviziv “Top Channel” për emisionin “Big Brother Vip”.

2. Administrimi dhe qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së kërkesës së shtetasit A.Gj, Këshilli i Ankesave e informoi atë se deri në datën e mbërritjes së kërkesës së tij, KA nuk i kishte propozuar Bordit të AMA-s sanksione financiare për BBVA.

Paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Avokati i Popullit	Top Channel	“Big Brother Vip”	19.02.2024

1. Objekti

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një shkresë nga institucioni i Avokatit të Popullit përmes së cilës kërkohej informacion *“lidhur me qëndrimin e mbajtur dhe veprimet e ndërmarra në lidhje me ankesën e Organizatës “Vish këpucët e mia”*”.

2. Administrimi dhe qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s bëri me dije institucionit të Avokatit të Popullit procedurën e administrimit të kërkesës në fjalë dhe vendimarrjen përkatëse si më poshtë vijon:

- Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i ka mbërritur një ankesë nga Organizata *“Vish këpucët e mia”* përmes postës elektronike në datën 30 Janar 2024, me anë të së cilës, pretendohet se *“në emisionin “Big Brother Vip”, transmetuar në televizionin Top Channel, gjatë transmetimit, një anëtar i programit (Gazi), përdori gjuhë urrejtje duke përdorur fjalë që nxisin diskriminimin dhe rrisin stereotipet e shikuesve për komunitetin Rom...”*
- Nga verifikimet e kryera pas marrjes së ankesës së mësipërme, Këshilli i Ankesave nuk konstatoi transmetimin e materialit të referuar në datën e pretenduar, 27 Janar 2024, ora 21:15.
- Kjo gjë ju bë me dije organizatës *“Vish këpucët e mia”* përmes postës elektronike në datën 1 Shkurt 2024 ku i kërkohej të specifikonte saktësisht subjektin audioviziv, datën dhe orën e saktë të transmetimit për përmbajtjen e pretenduar.
- Në vijim të komunikimit, Organizata *“ Vish këpucët e mia”* dërgoi në adresë të Autoritetit të mediave Audiovizive përmes postës elektronike, në datën 5 Shkurt 2024 link-un e videos së publikuar në platformën You Tube *“video të cilën e kemi shkarkuar në platformën You Tube të organizatës..., me qëllim përdorimi nga autoriteti”* – dhe - se *“Kjo video është publikuar nga disa rrjete sociale”*.
- Në kthimin e përgjigjes referuar ankesës së Organizatës *“Vish këpucët e mia”*, mbërritur në AMA përmes postës elektronike në datën 5 Shkurt 2024, Këshilli i Ankesave e sqaroi përsëri ankuesin se ***“Nga verifikimet e kryera pas marrjes së shkresës suaj, (në formularin e ankesës, ju referoni datën 27 Janar 2024, ora 21:15), Këshilli i Ankesave nuk konstatoi transmetimin e materialit, për të cilin ju ankoheni, në subjektin audioviziv Top Channel, në orarin e referuar”***.

Gjithashtu, ankuesit ju bë me dije se *“bazuar në dispozitat e ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 2 “Fusha e zbatimit”, përcakton se: “Ky ligj zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre”. Por edhe pas ndryshimeve të fundit, të Prillit 2023, konkretisht me ligjin 30/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mediat online dhe rrjetet sociale vijnë të mbeten jashtë objektivit të veprimtarisë së AMA-s”*.

Për sa më sipër, ankuesi – Organizata “Vish këpucët e mia” u njoftua se “ ***Për sa kohë përmbajtja është publikim në rrjetet sociale, është jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive. Për rrjedhojë, administrimi i ankesës është jashtë kompetencave të këtij Autoriteti***”.

- Në datën 8 Shkurt 2024 në adresën e Autoritetit të Mediave Audiovizive ka mbërritur një tjetër ankesë nga Organizata “ Vish këpucët e mia” në lidhje me të njëjtën video por referuar datës së transmetimit 21 Janar 2024 në orare të ndryshme.
- Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori në shqyrtim ankesën e mbërritur në institucionin tonë përmes postës elektronike në datën 08 Shkurt 2024, ku Organizata “Vish këpucët e mia” ripërsëriste shqetësimin “*lidhur me emisionin “Big Brother Vip”, transmetuar në televizionin Top Channel në datën 21 Janar 2024*”, referuar orareve të ndryshme.
- Nga verifikimet e kryera, Këshilli i Ankesave nuk konstatoi transmetimin e materialit të pretenduar në programacionin e subjektit audioviziv Top Channel të datës 21 Janar 2024.
- Sikurse edhe në komunikimet e me mëhershme, ankuesit ju bëjmë me dije se , “Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) shqyrton çdo ankesë bazuar në dispozitat e ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 2 “Fusha e zbatimit”, i cili përcakton se: “*Ky ligj zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar*”.
- Gjithashtu edhe pas ndryshimeve të fundit, të Prillit 2023, konkretisht me ligjin 30/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, **mediat online dhe rrjetet sociale vijnë të mbeten jashtë objektivit të veprimtarisë së AMA-s.**
- Për sa më sipër, materiali i referuar nga Organizata “Vish këpucët e mia” në kanalën zyrtar të subjektit audioviziv Top Channel, në You Tube, mbetet jashtë fushës së zbatimit të Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe del jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.XH	Top Channel	“Big Brother Vip”	13.03.2024

1. Objekti i ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga shtetasi A.Xh përmes së cilës shprehte shqetësimin se në emisionin “Big Brother Vip 3”, transmetuar në televizionin Top Channel, njëri prej konkurrentëve “në mënyrë të drejtëpërdrejtë është shprehur që brenda ambjenteve të shtëpisë janë futur substanca ilegale”.

2.Administrimi i ankesës dhe qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadrin e administrimit të ankesës, për të mundësuar verifikimin e paanshëm të përmbajtjes audiovizive përkatëse dhe trajtimin e mëtejshëm të saj , Këshilli i Ankesave i kërkoi ankuesit plotësimin e ankesës me datën dhe orën e transmetimit të sekuencës përkatëse.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
D.Ç	Top Channel	“Big Brother Vip”	30.03.2024

1. Objekti i ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një shkresë nga shtetasja D.Ç përmes së cilës ankuesja shpreh shqetësimin për mënyrën se si emisioni televiziv, Reality Show Big Brother Vip 3, transmetuar në Top Channel përdor fëmijët gjatë transmetimeve audiovizive.

2.Administrimi dhe qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadrin e administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave evidentoi mungesë të elementeve të ankesës dhe i kërkoi ankueses plotësimin e formularit të ankesës duke specifikuar të dhënat e nevojshme, me qëllim trajtimin e mëtejshëm të ankesës nga ana e AMA-s.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E. D			01.04.2024

1. Objekti i Ankesës

E. D i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave me pretendimin se në një transmetim televiziv kishte parë, sipas saj, një gjest të pahijshëm të një prej pjesëmarrësve në emision.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive evidentoi mungesën e elementëve të domosdoshëm për vijimin e trajtimit të problematikës, ndaj dhe i kërkoi ankueses plotësimin e të dhënave në kuadër të administrimit të saj.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
F. R	Media përgjithësi	Etika	25.04.2024

1. Objekti i Ankesës

F. R kërkoj nga Autoriteti i Mediave informacion në lidhje me disa vendimmarrje të Këshillit të Ankesave mbi ankesat që referonin kryesisht shkeljen e të drejtave të fëmijëve në programet audiovizive.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesave, Këshilli i Ankesave i referoi ankuesit linqet e raporteve vjetore të Autoritetit për periudhën kohore të kërkuar si dhe linqet e Buletineve përkatës të Këshillit të Ankesave publikuar në faqen zyrtare të Autoritetit. Po kështu, ankuesit iu shpjegua se Autoriteti, nisur nga detyrimi i vet ligjor për të ndikuar as pozitivisht dhe as negativisht pozicionin e OSHMA-ve përkatëse në treg, nuk e bën publik në mënyrë të dedikuar identitetin e OSHMA-ve, që janë kapur në shkelje apo në shmangie as në raportimin e AMA-s dhe KA-së para Komisionit parlamentar të medias.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Dhjetëra ankues	“Big Brother Vip 3”	Televotimi	07.05.2024

1. Objekti i Ankesës

Dhjetëra ankues i kërkuar Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), zbardhjen e televotimit gjatë emisionit “Big Brother Vip 3”, transmetuar në “Top Channel”.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes dhe shqyrtimit të ankesave, Këshilli i Ankesave i informoi ankuesit se kërkesa e tyre ishte jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, veprimtaria e të cilit bazohet në Ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ky ligj, apo edhe aktet nënligjore të dala për dhe në zbatim të tij, nuk parashikojnë ndërhyrjen e AMA-s në pretendime që dalin nga mosmarrëveshje të natyrës tregtare mes palëve private.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
T.B	EuroNews	-	08.05.2024

1. Objekti i Ankesës

“Përdorimi i gjuhës standarde shqipe në përmbajtjet audiovizive”, ky ishte shqetësimi i T.B, i cili i dërgoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë AMA-s. Ai i kërkoj Autoritetit marrjen e masave për përdorimin standard të Gjuhës Shqipe nga transmetuesit audioviziv.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, ankuesit iu bë me dije se Gjuha Shqipe standarde, e folur dhe e shkruar është në fokus të punës së Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive. Verifikimi i përmbajtjeve të transmetuara audiovizive nga Autoriteti bazohet në kërkesat e ligjit 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar, në kërkesat e Kodit të Transmetimit si edhe aktet e tjera nënligjore në fuqi.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A. N	-	-	14.05.2024

1. Objekti i Ankesës

A.N i dërgoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive me pretendimin se një emision përmbante informacion të rremë kundrejt personit të tij.

2.Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive evidentoi mungesën e elementëve të domosdoshëm për vijimin e trajtimit të problematikës, ndaj dhe i kërkoi ankuesit plotësimin e të dhënave në kuadër të administrimit të saj.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A. P	-	-	24.05.2024

1. Objekti i Ankesës

A.P depozitoi një ankesë në Këshillin e Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive me pretendimin se në rubrikën “*Moti sot dhe nesër*”, transmetuar në Televizionin Klan “...kur tregohet koha në Europë tregohen emrat e të gjithë kryeqyteteve të Europës dhe Ballkanit dhe emri i Tiranës, kryeqytetit tonë nuk tregohet”.

2.Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave shqyrtoi përmbajtjen audiovizive përkatëse, konkretisht parashikimin e motit në Televizionin Klan dhe evidentoi se rubrika në fjalë fillonte me parashikimin e motit në kontinentin e Europës duke ju referuar hartës së Europës ku shiheshin emrat e kryeqyteteve europiane dhe menjëherë më pas, në një hapësirë të dedikuar, publikohej parashikimi i situatës meteorologjike në Shqipëri duke ju referuar hartës së Shqipërisë ku shfaqej emri i kryeqytetit dhe qyteteve kryesore të vendit.

Për sa më sipër, Këshilli i Ankesave konstatoi se Televizioni Klan i kushtonte një hapësirë të dedikuar parashikimit të motit në të gjitha qytetet dhe kryeqytetin e Shqipërisë dhe se përfshirja e emrit të Tiranës në hartën e parashikimit të motit në Europë nuk mund të konsiderohej mungesë.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Q. H	-	-	10.06.2024

1. Objekti i Ankesës

Q.H i dërgoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive me kërkesën që Autoriteti të ndërhyjë në “ndalimin e termit *“leku i vjetër”*- si dhe –*“për përdorimin e gjuhës standarde shqipe”*.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në lidhje me pretendimet e ankuesit, Këshilli i Ankesave bëri me dije se Gjuha Shqipe standarde, e folur dhe e shkruar është në fokus të punës së Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive. Gjithashtu ankuesi u informua se në cilësinë e autoritetit rregullator, AMA do të vijojë t'i ketë në vëmendje operatorët mediatikë audiovizivë dhe respektimin e standardit në prezantimin e vlerave monetare.

Nga monitorimet e kryera nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), është evidentuar se në pjesën më të madhe të rasteve terminologjia që i referohet vlerave monetare të monedhës kombëtare Lek, është e shprehur qartë. Por ka dhe jo pak raste kur artikulohej vlera të diferencuara në *“Lek të vjetër”* ose *“Lek të ri”*, koncepte të tejkaluara, që lidhen me reformën monetare të vitit 1965, kur zyrtarisht Shqipëria realizoi një proces të zëvendësimit të kartëmonedhave të vjetra me modelin e ri.

Ankuesi u informuas se AMA ka nxitur dhe vijon të inkurajojë OSHMA-të për njehsimin e emërimit, duke u bazuar te standardi, si një qëndrim realist dhe profesional në informimin dhe analizimin e dukurive ekonomike e financiare, apo dhe në atmosferën e lojërave zbavitëse e kuiceve që shpallin fitues mes pjesëmarrësve.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Redaksia Zëri	-	-	14.06.2024

1. Objekti i Ankesës

Përfaqësuesit e redaksisë *“Zëri”*, i nisën një ankesë Këshillit të Ankesave me pretendimin se *“regjisor B.K kishte përdorur gjuhë seksiste ndaj femrave në një transmetim audioviz”*. Sipas

ankuesve, kjo deklaratë ishte ripërsëritur prej regjisorit edhe në intervistën e zhvilluar për portalin e tyre.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive evidentoi mungesën e elementëve të domosdoshëm për vijimin e trajtimit të problematikës, ndaj dhe i kërkoi ankuesit plotësimin e të dhënave të ankesës në kuadër të administrimit të saj. Në lidhje me materialin e publikuar, në linkun vijues: “<https://zeri.ai/aktualitet/regjisor-aktordhe-ist-bujar-kapexhiu-nuk-heq-dore-grate-skane-hum-i20387>”, ankuesit iu bë me dije se sipas dispozitave të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 2 “Fusha e zbatimit”, përcaktohet se “Ky ligj zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar”.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A. S/R. R			26.06.2024

1. Objekti i Ankesës

A. S dhe R. R i drejtuan një ankesë Këshillit të Ankesave me pretendimin se në datën 09.03.2024, emisioni “Pa gjurmë”, kishte transmetuar një video në të cilën “*prishej imazhi i ankuesve dhe i kunetërve*”. Ankuesit pretendonin se gazetarja i kishte kontaktuar, duke zhvilluar intervistën në kafe.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave verifikoi përmbajtjen audiovizive të emisionit “Pa Gjurmë”, transmetuar në televizionin Report TV në datën e referuar, 07/06/2024 dhe nuk konstatoi transmetimin e videos së pretenduar prej ankuesve.

KOMUNIKIME TREGTARE

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
AWA, AWEN, GADC	Top Channel	Reklamë	14.06.2024

1. Objekti i Ankesës

Koalicioni kundër seksizmit (AWA, AWEN, GADC) përmes një shkrese dërguar pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i kërkoi Këshillit të Ankesave heqjen e reklamës se Lori Caffë-së

që shfaqej në “Top Channel”, pasi sipas tyre seksualizonte figurën e femrës, konkretisht përmes Rike Roçit, duke përdorur trupin e saj për të tërhequr vëmendjen për produktin e tyre, kafënë e ftohtë në kanaçe. Koalicioni pretendonte se shfaqja e një komunikimi tregtar të tillë, kishte ndikim negativ në perceptimet shoqërore për rolet gjinore dhe forcimin e stereotipeve të dëmshme.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave shqyrtoi rastin dhe evidentoi se reklama e Lori Caffë-së promovonte linjën e re të kafesë së ftohtë, e cila ilustruhej nga një modele e veshur me rroba banje, e cila përpiqej të thyente një kub akulli brenda të cilit gjendej një kanaçe kapuçinoje.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në vendimmarrjen e tij, Këshilli i Ankesave gjykoi se përmbajtja audiovizive e reklamës në fjalë ishte ideuar për të evidentuar risitë e produktit që reklamohet, sikurse ishte promovimi për herë të parë i linjës së ftohtë të kafes Lori në një sezon të nxehtë veror. Si përfundim, përfshirja e modeles me rroba banjo në reklamë dhe çdo element tjetër freskues i shërbente marrëdhënies me produktin dhe reklamimit të tij.